



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:251062  
Datë: 30.12.2024  
Numri i dokumentit: 06666952

C.nr. 2023:251063

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit R.H nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Av. Abdurrahim Islami nga Ferizaj kundër të paditurës Komuna e Ferizajt - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-QKMF, baza juridike: Kompensim i pagës 13-të, vlera e kontestit: 1659 euro, jashtë seancës, me datë 30.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit R.H me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET e paditura Komuna e Ferizajt – Drejtoria për Shëndetësi që Paditësit: t'ia paguajë pagën e 13-të, për vitin 2018, 2019, 2020, në shumën e tërësishme prej 1659,00 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimi të dhunshëm.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij më dt. 17.11.2023, kanë paraqitur padi kundër të paditurës, me objekt kontesti: Kompensim i pagës 13-të, duke përshkruar gjendjen faktike si në vijim: Parashtruesi i kësaj padie është i punësuar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Ferizaj. Kjo dëshmohet edhe me kopjet e bashkangjitura të kësaj padie. Me datën 12.06.2018 hynë në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale, ku në bazë të kësaj marrëveshje bazuar në nenin 17 par 2 i takon e drejta në 3 paga në lartësinë e pagës bazë dhe atë për vitet 2018, 2019, 2020. Përkundër obligimit ligjor që në mënyrë zyrtare të bëhet zbatimi i kësaj kontrate lidhur më këtë padi, dhe atë brenda afatit një muor pas plotësimit të kushteve, deri me tani parashtruesit i padisë nuk është kompensuar për këto paga të trembëdhjeta ashtu siç parashihet në nenin 17 par 2 te Kontratës Kolektive Sektoriale për Shëndetësi. Meqenëse Kontrata Kolektive Sektoriale nuk po zbatohet zyrtarisht ashtu siç është obligimi ligjor, paditësi i është drejtuar të paditurës me kërkesë për kompensim të pagave të 13-ta pikërisht në mbështetje të nenit 17 par 2 të Kontratës Kolektive dhe ndaj të njëjtave organi përgjegjës edhe me tutje nuk ka marrë asnjë veprim qoftë për refuzimin apo përmbushjen e këtyre kërkesave. Konsiderojmë se Komuna e Ferizajt -

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - QKMF me kohë do duhej të bënin planifikimin e duhur buxhetor edhe për këtë obligim. Për më tepër paditësi pretendon se e paditura i ka pasur mundësitë financiare për ta përmbushur këtë obligim por të njëjtin ka dështuar ta realizojë më tepër për shkak të neglizhencës në ndërmarrje të veprimeve të duhura në drejtim të realizimit të të drejtave të punëtorëve të saj. Andaj paditësi tani kërkon nga gjykata që të ushtroj funksionin e saj dhe mos te lejoj shkeljen e të drejtave të paditësit dhe të restauroj kundërligjshmërinë e ndodhur, përkatësisht të vendos në atë mënyrë që në tërësi të respektohet përveç të tjerash parimi i përmbushjes së detyrimeve nga neni 8 i LMD në fuqi dhe pas analizimit të të gjitha fakteve dhe provave të prezantuara i propozojmë gjykatës që pas administrimit të provave kërkesëpadinë e paditësit të e aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes përgjigje në padi ka theksuar se: E kontestojmë në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë lidhur me pagat e 13-ta, ngase me nenin 17 par.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale (Shëndetësisë), punëmarrësit ka mundur të i kompensohet paga e 13-të, për çdo vitë kalendarik në vlerë të pagës bazë sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit, mirëpo në këtë rast punëdhënësi nuk ka pasur mundësi buxhetore që paditësit të ju bëjë kompensimin e pagës 13-të. Andaj, nga të lartcekurat i propozojë gjykatës që pas shqyrtimit të lëndës dhe të administrimit të provave të marr aktgjykimi refuzues.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitën e nenit 8 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

-Kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e PABAZUAR.

Gjykata lidhur me çështje ka vendosur jashtë seancën gjyqësore dhe atë referuar vendimit të GJEDNJ-së Saccoccia kundër Austrisë (Aktgjykim i 18 dhjetorit 2008), pasi pretendimet e palëve kanë qenë qarta dhe të njëjtat ngërthenin çështje ekskluzivisht ligjore të cilat nuk e kanë bërë të domosdoshme mbajtjen e seancës publike, në ndërlidhje edhe me natyrën jo komplekse e çështjes, e ndërlidhje me nenin 399 par.1 të LPK-së që përcakton se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se pala paditëse ishin e punësuar tek e paditura dhe se gëzonin shpërblimin në emër të pagës bazë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, mirëpo kontestues ishte baza e kërkesëpadisë, pra nëse palës paditëse i takon apo jo e drejta lidhur me kompensim të pagave të 13-ta të papaguara.

Në bazë të kontratës mbi marrëdhënien e punës, me numër protokollit .. të dt. ...., e lidhur në mes të palëve ndërgjyqëse, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka të themeluar marrëdhënien e

punës tek e paditura me kohë të pacaktuar dhe gëzon shpërblimin në pagën bazë prej 543,00 euro, fakt i cili nuk ishte kontestues në mes të ndërgjyqësve.

Gjykata lidhur me bazën e kërkesëpadisë, ka vendosur duke u bazuar në nenin 17.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale e datës 12.06.2018 e lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, ku përcaktohet se “Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 – të për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”.

Në interpretim të kësaj dispozite ligjore, çështja e kompensimit të pagës së 13-të, për punëtorët shëndetësor është e kushtëzuar me mundësitë financiare të punëdhënësit, përkatësisht nëse ka mjete buxhetore. Nga kjo rezulton se dispozita e sipër theksuar duhet interpretuar në atë mënyrë që e drejta për realizimin e pagës së 13-të, lind kur punëdhënësi nuk e përmbush atë, ndërsa në asnjë mënyrë nuk arrin të provoj se nuk ka pasur mundësi buxhetore. Sipas kësaj gjykate, nëse punëtori paraqet kërkesë për kompensimin e shpërblimit të pagës së 13-të, duke pretenduar se ka plotësuar kushtet e përcaktuara, mbetet në barrën e punëdhënësit që në secilën fazë të procedurës kur gjykata i jep mundësi për tu deklaruar me prova konkrete, të provoj çështjen e mundësisë buxhetore, për shpërblimin e tillë. (Mendimi Juridik i miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, të datës 09 tetor 2023).

Sipas Ligjit nr. 06/L-020 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, buxheti për paga dhe mëditje në Komunën e Ferizajt ka qenë 15,222,016 euro. Në nenin 12 par. 4 të këtij ligji është përcaktuar se shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve “Mallra e shërbime” nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve, qoftë në formë të mëditjeve apo si kontribute në mall, përfshirë këtu shujtat apo dhuratat. Në anën tjetër, sipas raportit të auditimit për komunën e Ferizajt për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018 të publikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit, rezulton se buxheti final për paga dhe mëditje ka qenë në shumë prej 15,151,632 euro ndërsa realizimi për vitin 2018 ka qenë 15,081,908 euro. ZKA ka konstatuar se realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte rreth 99%. Shkurtimi i buxhetit për paga dhe mëditje për 132,614€ ishte si rezultat i mos realizimit të fondeve të ndara.

Sipas Ligjit mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, buxheti për paga dhe mëditje në Komunën e Ferizajt ka qenë 15,500,748 euro. Në nenin 12 par. 4 të këtij ligji është përcaktuar se shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve “Mallra e shërbime” nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve, qoftë në formë të mëditjeve apo si kontribute në mall, përfshirë këtu shujtat apo dhuratat. Në anën tjetër, sipas raportit të auditimit për komunën e Ferizajt për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2019 të publikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit, rezulton se buxheti final për paga dhe mëditje ka qenë në shumë prej 15,524,084 euro ndërsa realizimi për vitin 2019 ka qenë 15,310,882 euro, apo shprehur në përqindje është realizuar prej 99%. ZKA ka konstatuar se buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 23,335.75€ Nga të hyrat vetanake të bartura janë shtuar 10,000€ dhe nga grandet e donatorëve 13,336€.

Sipas Ligjit mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, buxheti për paga dhe mëditje në Komunën e Ferizajt ka qenë 15,625,776euro. Në nenin 12 par. 6 të këtij Ligji është përcaktuar se shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve, qoftë në formë të shtesave apo si kontribute në mall, përfshirë këtu shujtat apo dhuratat, duke përfshirë rimbursimin apo shpenzimet e lejuara për udhëtimet jashtë vendit, sipas legjislacionit përkatës. Përderisa sipas raportit të auditimit për komunën e Ferizajt për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2020 të publikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit, rezulton se buxheti final për paga dhe mëditje ishte 15,883,081€, prej tyre ishin shpenzuar 15,865,122€ apo rreth 100%. ZKA ka konstatuar se Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 257,305€, i cili ishte shpenzuar 100%. Sipas raportit të ZKA, rezervat në këtë kategori janë zero.

Nga Ligjet përkatëse të cituara si më lartë, përkatësisht në raport me zërat për ndarje buxhetore, rezulton se Komuna e Ferizajt nuk ka ndarë asnjë linjë buxhetore për paga të 13-ta për vitet 2018, 2019 dhe 2020, e në anën tjetër realizimi i buxhetit për paga dhe mëditje është realizuar në atë masë sa nuk rezulton rezervë buxhetore për të mbuluar pagat e 13-ta për punonjësit, përkatësisht në rastin konkret paditësin.

Nga interpretimi dhe arsyet si më lartë, gjykata ka vendosur që të refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Gjykata ka vlerësuar dhe pretendimet e tjera të palës paditëse e po ashtu edhe asaj të paditur, por të njëjtat nuk kishin ndonjë rëndësi për vendosje ndryshe nga ana e gjykatës, sepse padisë i ka munguar baza juridike.

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata ka vendosur bazuar në nenin 450 “Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta”, e lidhur me nenin 463.1 “Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën”-të LPK-së.

Nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e bazuar në nenin 399 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
C.nr.2023:251063, datë: 30.12.2024

Gj y q t a r i:  
Armend Ahmeti

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes të kësaj gjykate.